



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Procesverbal i mbajtur më 27 dhjetor 2024, në mbledhjen e XXXI-të (tridhjetenjë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokrri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi, bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës edhe; Saranda Stublla drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, Vigan Salihu drejtor i drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, Avni Fetahu drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Liridon Gashi drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, Bahri Selimi drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke konstatuar kuorumin, në vazhdim theksoi, thirrja dhe materiali i kësaj mbledhje besoj se ju është dërguar me kohë të gjithëve, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, përshëndetje për të gjithë, si pikë e re e rendit të ditës propozoj vendimin për kompensimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale. Në këtë propozim vendim hyn Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve”, Ndërmarrja Publike Lokale për Banim, si dhe Ndërmarrja Publike Lokale “Eko-Llapi”.

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, theksoi, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës që është nxjerr me 23 maj 2024 ku ky vendim është nxjerr për Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Llapi”, ndërsa ky propozim vendim i tanishëm përfshin të gjitha Ndërmarrjet Publike Lokale, kurse vendimet e mëhershme anulohen.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim, propozimin e drejtoreshës së DPKGJ që kjo pikë të hyjë në rend të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se në propozim të znj.Saranda Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë në emër të Ekzekutivit të Komunës, nga 8 anëtar/e të Komitetit sa ishin prezent në mbledhje me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi për përfshirjen si pikë shtesë në këtë mbledhje edhe:

- Propozim Vendimin për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë (NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL Eko-Llapi)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër kërkon fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe pikën shtesë e cila u përkrahë paraprakisht.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 8 anëtar/e të Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan) miratohet rendi i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe pikën shtesë të prezantuar në fillim të mbledhjes dhe materialit të shpërndarë anëtarëve të Komitetit:

- Propozim Vendimin për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë (NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL Eko-Llapi)

1. Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2024

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, është pika e parë e rendit të ditës dhe për këtë pikë Kryetari i Komunës nuk është prezent sot në këtë mbledhje, por nëse Nënkryetarja e Komunës dëshiron mund të merr fjalën.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, pika e parë e rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës është Raportimi i Kryetarit të Komunës për vitin 2024, dhe nuk kam çka të shtoj më shumë përveç që të vazhdohet me votim në mënyrë që të jetë pjesë e seancës së rregullt të Kuvendit.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim që kjo pikë, pra raportimi i Kryetarit të Komunës për vitin 2024, të jetë pikë e rendit të ditës në seancën e Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës, por është diçka që kam një vërejtje sepse është fundi i vitit dhe data 30 dhjetor për përmbushjen e një obligimi ligjor që e përcakton ligji që Kryetari brenda vitit duhet dy here të raportoj për gjendjen ekonomiko-financiare dhe dinamikën e realizimit të projekteve të miratuara nga ky Kuvend, mirëpo sido qoftë më mirë vonë se hiç, dhe ne do ta përkrahim si përmbushje e obligimit ligjor. Pra e theksova që Kryetari i Komunës e ka për obligim të raportoj sa herë që kërkon Kuvendi dhe sa e di unë ky Kuvend nuk ka kërkuar që Kryetari të raportoj, mirëpo pavarësisht kërkesave të anëtarëve të Kuvendit është obligim ligjor që dy herë në vit detyrimisht të raportoj dhe ne po presim raportimin me datë 30 dhjetor edhe pse po e përmbylim në një datë pak sa e vonuar tani kur kemi hyrë në fazën e festave të fund vitit. Sidoqoftë do ta përkrahim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim raportimin e Kryetarit të Komunës në Kuvend, pra është obligim ligjor por edhe me Plan të punës, mirëpo edhe unë kam një vërejtje të vogël sa i përket datës sepse është dita e parafundit e vitit, kështu që ne e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, Kryetari i Komunës ka pasur shumë angazhime në këto ditët e fundit dhe e kemi pasë problem për caktimin e datës, ndërsa jeni në dijeni që edhe në fillim të këtij muaji kemi mbajtur një mbledhje, kështu që edhe koha na është kufizuar dhe nuk kemi pasë mundësi pa i'u përmbajtur afatit 7 ditë pune për dërgimin e materialit, përndryshe ne do ta mbanim edhe më herët këtë mbledhje por mundësi për ta dërguar materialin brenda afateve ligjore nuk ka qenë. Pra kjo ka qenë e vetmja arsyeje.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne e kemi fjalën për pikën e parë të rendit të ditës dhe folëm që është e vonuar në kuptimin e raportimit por në asnjë fjalë nuk ishim duke e diskutuar datën e seancës dhe para se gjithash zotëri Kryesues ta kesh parasysh që ajo karrige ku ti je ulur është për mbarëvajtjen e diskutimeve të Kuvendit dhe jo për të dhënë arsyeime për diçka që nuk është e jotja.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, data u përmend nga z.Bashkim Sylja dhe kjo nuk pati fare lidhje me ty i nderuar Çunaku. Pra zotëri Sylja e përmendi që është kohë feste dhe kjo datë është afër festës.

z.Naim Çunaku, theksoi, jo vetëm kolegu z.Bashkim Sylja por edhe unë e theksova atë se data e mbledhjes është afër festave.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës që tui rekomandohet për Kuvend.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 8 vota Për nga të pranishmit në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet kjo pikë e rendit të ditës.

2. Drafti Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban në Komunën e Podujevës 2025-2029 - Raporti i Punës

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, siç jeni edhe në dijëni Plani i mobilitetit është një plan shumë i nevojshëm për Komunën e Podujevës dhe është një plan i cili ka filluar shumë herët të hartohet dhe përgatitet, mirëpo për shkak të disa ndryshimeve që janë bërë në mobilitetin e komunikacionit të Komunës së Podujevës ka mbetur deri tani i pa aprovuar. Ne kemi marr të gjithë hapat e mundshëm ku kemi formuar edhe një komision profesional për ndryshimet të cilat është dashtë të bëhen për shkak të ndërrimit të vendstacionit të autobusëve, ky komision është cekur edhe në Draftin e fundit ku janë inxhinierët e komunikacionit të cilët e kanë bërë një punë të madhe rreth këtij Plani.

Disa ndryshime teknike në këtë Plan duhet të bëhen mirëpo këto ndryshime do t'i paraqes në Kuvend e që kryesisht janë vetëm gabime teknike dhe po ashtu në seancën e Kuvendit ju ftoj që ta votoni Planin në fjalë sepse është shumë i rëndësishëm për Komunën e Podujevës. Pra të hënën do të diskutojmë më gjerësisht për këtë Plan, po ashtu për ndryshimet që janë bërë në të sigurisht që i gjëni në raportin e punës së komisionit, pra të gjitha ndryshimet që janë paraqitur, prandaj kërkoj që sot të përkrahet ky Plan që të rekomandohet për Kuvend.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje për rekomandim në Kuvend.

Pas votimit, kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 8 vota Për, nga anëtarët e pranishëm, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Diskutim për parandalimin e fenomeneve negative të adoleshentëve dhe të rinjve në Komunën e Podujevës (vazhdim i diskutimit nga mbledhja e kaluar e mbajtur më 11.12.2024)

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës dihet që është diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar të Kuvendit por është kërkuar që edhe në mbledhjen e radhës të diskutohet. Kjo pikë ka ardhur si propozim nga kolegu z.Ragip Fetahu dhe besoj që jeni të gjithë të mendimi që edhe kjo pikë të kaloj në Kuvend diskutim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 8 vota Për, nga anëtarët e pranishëm,, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj pike të rendit të ditës.

4. Propozim Vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë

(NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL Eko-Llapi)

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra kemi një propozim që të miratohet vendimi për caktimin e kompensimit të komisioneve të aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale të Komunës së Podujevës siç janë NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A. Podujevë, NPL për Banim Sh.A Podujevë, NPL Eko-Llapi Sh.a Podujevë, ndërsa neni dy thekson që anëtarët e komisioneve të aksionarëve do të kompensohen për çdo muaj në lartësi të pagës minimale. Pra ne një vendim e kemi marr dhe drejtori i DPZHE propozoi që të anulohet ai vendim, nuk e di sa kemi bazë ligjore që të anulohet ai vendim ku ende nuk është kthyer përgjigje nga Ministria që ka qenë vendimi për kompensimin e anëtarëve të komisionit për Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko-Llapi”, pra përgjigja për atë vendim nuk është kthyer ende nga Ministria e Financave nga e cila siç e cekta ende nuk kemi ndonjë përgjigje, kështu që për anulimin e tij duhet të bëjmë konsultimet ligjore.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ky vendim është i njëjtë me atë që është marr për NPL Eko-Llapi, mirëpo ky vendim e rregullon këtë çështje për të gjitha Ndërmarrjet Publike Lokale ku është aksionare Komuna e Podujevës, pra Kuvendi i Komunës së Podujevës i ka zgjedhur përfaqësuesit e vetë në këto Ndërmarrje kështu që nuk ka asnjë problem ligjor me atë që u theksua nga Kryesuesi. Të mos harrojmë që ne e dimë që nëse Ministria brenda 15 ditëve nuk e kthen përgjigjen që vendimi nuk është i ligjshëm, ai vendim hyn automatikisht në fuqi si i ligjshëm.

Pra ky propozim vendim e rregullon statusin e aksionarëve për të gjitha Ndërmarrjet Publike Lokale të Komunës së Podujevës dhe është e mirë që po rregullohet edhe për të ardhmen dhe nuk do të ketë më probleme sepse aksionarët për ta zhvilluar Ndërmarrjen Publike Lokale duhet të kenë një kompensim për punën që bëjnë, kështu që unë mendoj që ky vendim është në rregull ligjërisht dhe që të zhvillohen këto Ndërmarrje si dhe nuk ka asnjë bazë ligjore që ky vendim të jetë në kontest me atë që e kemi marr më herët, pra është i njëjti.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë vetëm e theksova që vendimin që e kemi dërguar në Ministri për komisionin e Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi”, dhe nuk diskutova dhe nuk e kontestova sepse nuk jam unë për t’i kontestuar, mirëpo për anulimin e atij vendimi e theksova se duhet të shikohen procedurat se si do të shkojmë.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur e kemi parasysh këtë propozim vendim për një vendim që vërtetë do të ketë një kosto financiare për këto Ndërmarrje Publike pa dashtë që të hyjë në bazën ligjore të këtij vendimi që për mendimin tim ka vend të diskutohet por nuk jam unë ai që e bëjë, në veçanti dy elemente të këtij vendimi dhe nuk e di se sa janë shqyrtuar sepse prodhojnë efekt/fuqi retroaktive dhe prodhojnë efekt për dy-tri vite, dhe kur paraqitet se sa është paga minimale në ato Ndërmarrje, pra do të thotë që kemi të bëjmë me një kosto të asaj Ndërmarrje që sigurisht do të ndikoj në afarizmin e saj.

Këtë që e përmendi edhe z.Bashkim Sylja mendoj edhe unë njëjtë kur kemi të bëjmë me aksionar që janë emëruar nga ky Kuvend të paktën duhet të trajtohen barabartë në të gjitha Ndërmarrjet ku ata funksionojnë.

Një diçka që propozuesi i këtij vendimi nuk e di a e ka pasur parasysh dhe do të doja që të na e sqaroj ku thotë se Ndërmarrja Publike Lokale për Banim Sh.A Podujevë, sa janë të punësuar aty cila është paga minimale në atë Ndërmarrje, sepse me këtë anëtarët e Kuvendit që janë në komision të aksionarëve në këtë Ndërmarrje sa unë kam njohuri nuk do të kenë pikë referente as për pagë minimale, pra nëse ndokush mund të na jap ndonjë sqarim në detaje do të ishte mirë.

Kështu që në këtë formë siç është, me vet faktin që ne e kemi përkrah një lloj të këtij vendimi për ndërmarrjen publike Eko-Llapi e kësaj Ndërmarrje në mbledhjen e Kuvendit i kemi dedikuar një pjesë nga

buxheti, pra një pjesë nga të hyrat buxhetore dhe në atë ditë është dashtë që të jenë edhe këto si dhe të trajtohen edhe këto dy Ndërmarrjet tjera, mirëpo si do që të jetë ne nuk jemi kundër sepse fundja i kemi koleg, por arsyeshmërinë e këtij vendimi dhe bazën ligjore të këtij vendimi unë nuk jam ai që të kontestoj, por dilemat i kemi e sidomos te fuqia retroaktive e këtij vendimi dhe te Ndërmarrja publike Banesore.

z.Vigan Salihu, theksoi, unë nuk jam aksionar në Ndërmarrjen Publike Lokale Banesore në Podujevë dhe nuk e di a është ndonjë aksionar i asaj Ndërmarrje i pranishëm këtu, kurse sa i përket pagës minimale kjo është e rregulluar edhe me Ligjet në fuqi që janë, pra paga minimale është në bazë të Ligjit në fuqi, edhe nëse ka qenë po supozojmë 200€, tash e pas nga hyrja në fuqi e Ligjit nëse nuk gaboj është 350€ bruto dhe duhet të rregullohet kjo çështje në secilën Ndërmarrje sepse nuk mund të ekzekutohet pagesë në kundërshtim me Ligjin për pagën minimale.

Sa i përket të punësuarve është mirë me qenë aksionari kompetent i Ndërmarrjes që të raportoj dhe të dimë në detaje për këto.

z.Naim Çunaku, theksoi, pyetje, në Ndërmarrjen Publike Banesore a ka të punësuar, përndryshe unë u thirra në barazinë e të gjithë anëtarëve të Kuvendit që ne i kemi caktuar por nëse e kemi një Ndërmarrje që asnjëherë në këtë Kuvend e që unë më shumë së një herë kam kërkuar që të raportohen me raporte periodike për gjendjen ekonomike financiare që e kanë edhe obligim ligjor, pra ashtu është obligim ligjor që aksionarët në ato Ndërmarrje Publike ku janë aksionar të paraqesin raport para Kuvendit të Komunës, por që edhe sot edhe gjatë gjithë kësaj kohe asnjëherë nuk kemi pasur raport, dhe unë sot si anëtar i Kuvendit Komunal të Podujevës i drejtohem Ekzekutivit të Komunës, në këtë rast drejtorit të drejtorisë përkatëse dhe të gjithëve, se cila është gjendja në Ndërmarrjen Publike Lokale Banesore në Podujevë, a është funksionale ajo Ndërmarrje, sa të punësuar i kemi aty, cilat janë detyrat e saj e që dikush duhet të jep shpjegim për këtë gjë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, as unë nuk jam kompetent për të folur për Ndërmarrjen Publike Lokale për Banim, mirëpo ne të gjithë e dimë që në çfarë gjendje kanë qenë Ndërmarrjet Publike Lokale të Podujevës, jo vetëm ajo Banesore por edhe Ndërmarrja Stacioni i Autobusëve. Kështu që ideja është që të hyjnë në funksion dhe të zhvillohen këto Ndërmarrje dhe të rigjenerohen të hyra dhe njëkohësisht të kryejnë shërbime, mirëpo sa është funksionale ne e dimë sepse ne gjendjen financiare e dimë si është por në mënyrë që të zhvillohen dhe të funksionalizohen, ky është qëllimi, unë mendoj që është vendim që i përfshin të gjitha Ndërmarrjet Publike Lokale.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të prezantuar në fillim të kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 7 anëtarët e Komitetit që ishin prezent në sallë, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të përmbajtur (1 anëtarë nuk mori pjesë në votim), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në mbledhjen e caktuar për datën 30.12.2024 dhe njëkohësisht shqyrtimin e këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të prezantuar në mbledhjen e KPF dhe bashkëngjitur konstatimeve të rekomanduara për Kuvendin e Komunës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, kam edhe një çështje para se të përfundojmë me këtë mbledhje. Siç jeni në dijeni në mbledhjen e kaluar kanë dhënë dorëheqje 2 anëtar të Kuvendit Komunal znj.Arjeta Abazi dhe z.Qendrim Softolli, pastaj ne i kemi zhvilluar procedurat për zëvendësim dhe Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve-KQZ ka marrë vendimet përkatëse sipas të cilave në vend të tyre anëtar/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës janë emëruar znj.Qendresa Haliti dhe z.Fatmir Gashi, duke zëvendësuar 2 anëtarët e lartëcekur, kështu që në mbledhjen e radhës këta 2 anëtarë të ri do të vijnë dhe

të japin betimin e tyre para Kuvendit të Komunës sepse sipas Ligjit janë anëtarë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Podujevës që nga momenti që kanë ardhur vendimet nga ana e KQZ-së.

Pra në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës kjo do të vendoset para rendit të ditës dhe këta do e japin betimin, përndryshe edhe janë anëtarë të rregullt të Kuvendit, prandaj të mbetet si rekomandim për Kuvendin e Komunës që këta anëtarët e rinj të Kuvendit që i ceka të japin betimin në mënyrë që t'i përfundojmë të gjitha procedurat e zëvendësimit të tyre.

Rekomandim:

Pas njoftimit se KQZ ka nxjerrë vendimet për zëvendësimin e dy anëtarëve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit rekomandoj që në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të caktuar për datën 30.12.2024 të ndërmerren hapat dhe veprimet përkatëse për dhënien e Betimit solemn si anëtar/e të Kuvendit të Komunës së Podujevës znj.Qendresë Haliti dhe z.Fatmir Gashi, dhe atë para se të fillohet me pikat e rendit të ditës.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35

**Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0081923/24
Podujevë,
27 dhjetor 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**